



**Të gjithë  
meritojnë një  
mundësi  
të dytë**

## **FTESË PËR BASHKËPUNIM!**

Qendra e Parandalimit të Kimeve të të Miturve dhe të Rinjve fton të gjitha institucionet arsimore dhe ato të pushtetit vendor që në zbatim të Kodit të Drejtësisë Pendale për të Mitur të bashkëpunojnë në implementimin e planeve të hartuara për riintegrin në shoqëri dhe komunitet të këtyre të rinjve.

Të parandalojë kriminalitetin tek të miturit dhe të rinjtë duke promovuar zhvillimin pozitiv nëpërmjet zbatimit të programeve parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese!

Duke ndjekur politika jo diskriminuese dhe larg paragjykimeve, të gjithë së bashku mund t'i hapim rrugën të miturve dhe të rinjve drejt një të ardhmeje larg krimtit.



**QPKMR e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit.**

Për më shumë informacion mbi Qendrën e Parandalimit të Kimeve të të Miturve dhe të Rinjve, konsultoni faqen e internetit:

**[www.qpkmr.gov.al](http://www.qpkmr.gov.al)**

**Qendra e  
Parandalimit të  
Kimeve të të  
Miturve dhe të  
Rinjve**

Mbështet të miturit dhe të rinjtë t'i rikthehen jetës në komunitet, larg rrugës së krimtit.



## Legjislacioni

Në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, QPKMR vepron si një person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

## Misioni

Reabilitimi dhe riintegrimi i të miturve dhe të rinjve pas kryerjes së dënimit, është qëllimi kryesor i qendrës. Në bashkëpunim me organet të tjera ligjzbatuese, QPKMR promovon dhe mbështet parandalimin e krimeve të kryera nga të miturit dhe të rinjtë.

## Veprimtaria

QPKMR Bashkëpunon me Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, për përgatitjen e planit të rishoqërizimit dhe të rehabilitimit duke synuar shëmangien në ripërfshirjen e të miturit në rrugën e krimit.

Koordinon Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, në mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit dhe përbushjes së planit të rehabilitimit, për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirimit me kusht të të miturit.

Administron Sistemin e Integruar të të Dhënavë të Drejtësisë Penale për të Miturit, me qëllim evidentimin e të dhënavë që lidhen me datat e fillimit dhe të mbarimit të dënimit.

Ndjek procesin e trajnimit e të specializimit të profesionistëve të drejtësisë për të miturit.

Mbikëqyr cilësinë e ofrimit të shërbimit ndaj të miturit.

## Hartimi i Planit

Plani i shoqërimit dhe rehabilitimit të të miturve dhe të rinjvë hartohet në harkun kohor të tre muajve pëpara datës së përfundimit të dënimit.

Në hartimin e planit merren ne konsideratë nevojat dhe kërkesat e secilit rast dhe

mbështetja që Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve jep është si vijon;

- Sigurimin e shpenzimeve të udhëtimit për në banesë.
- Veshje dhe strehim të përshtatshëm.
- Mbështetje psikologjike.
- Koordinim me institucionet arsimore për të mundësuar akses në shkolla dhe kurse të formimit profesional
- Bashkëpunim me zyrat e punësimit në të gjithë vendin
- Akses në paketat e kujdesit shëndetësor, përfshirë edhe rastet e aftesisë së kufizuar, varësisë nga droga apo të sëmundjeve të tjera.

**Në mënyrë që plani të jetë sa më efikas dhe pranë nevojave të secilit, ky plan përfshin jo vetëm të miturin apo personin që ka kryer dënimin por edhe familjen e tij.**